



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Tel-Fax:042 232491

Nr. 751/9 Prot

Tiranë, më 17.12.2016

V E N D I M

Nr. 145, Datë 17.12.2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË DEGËN E DOGANËS QAFË THANË - POGRADEÇ "MBI ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT DOGANOR NË PROCESIN E REALIZIMIT TË TË ARDHURAVE DOGANORE."

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit të paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar në ballafaqimin e organizuar me dakordësinë e tij më datë 05.12.2016 dhe observacionet e dërguara në KLSH, mendimin për cilësinë e auditimit të dhënë nga Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit të dhënë nga Kryeaudituesi i Departamentit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e legjislacionit doganor në procesin e realizimit të të ardhurave doganore", për periudhën 01.01.2013-30.06.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. *Megjithëse në periudhën 2015 deri 6/mujorin e parë të vitit 2016, niveli i realizimit të të ardhurave doganore është rritur në mënyrë ritmike, veprim i cili tregon për ngritjen e nivelit të përgjegjësisë funksionale të stafit drejtues aktual, por nga auditimi dhe analiza e realizimit të tyre sipas muajve për gjatë periudhës së audituar u konstatua se nga 42 muaj të programuar të ardhurat janë realizuar dhe tejkualuar vetëm në 20 muaj, ose në masën 47,6 % dhe nuk janë realizuar gjatë 22 muajve të tjerë, të cilët përbëjnë 52,4 % të periudhës së auditimit, për këto mos realizime nuk janë kryer analiza të dokumentuara për të nxjerr konkluzionet, shkaqet apo dhe përgjegjësitë individuale, të cilat kanë ndikuar në mos realizimin e të ardhurave doganore për çdo muaj të vitit, analiza të cilat do të sillnin rritjen e mëtejshme të të ardhurave në buxhetin e shtetit.*

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Pogradec gjatë periudhës së studimit për përgatitjen e programit të të ardhurave doganore në total dhe në strukturë për vitin në vazhdim, të kryej analiza të thella për arsyet dhe shkaqet kryesore, që kanë ndikuar dhe mund të ndikojnë në mos realizimin e të ardhurave për çdo muaj dhe ti paraqesë ato pranë DP Doganave, që të mbahen në konsideratë gjatë zbatimit të procedurave për detajimin mujor dhe vjetorë të të ardhurave, me qëllim realizimin ritmik të tyre.

Menjëherë

2. *Nga auditimi i borxhit doganor për periudhën e audituar 2013-30.06.2016 u konstatua se, në fund të periudhës së auditimit ai ka arritur në vlerë **77,625 mijë lekë për 27 subjekte**, e cila përbëhet nga **57,294 mijë lekë** detyrime doganore së bashku me penalitetet dhe **20,331 mijë lekë** kamatëvonesa të zbatuara nga zyra e financës, për mos pagimin në afat të borxhit të krijuar.*

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 57-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Qafë Thanë - Pogradec të marri masa të plota ligjore-administrative, me qëllim arkëtimin dhe rikuperimin e borxhit doganor të konstatuar në vlerë **77,625 mijë lekë**.

Në vijimësi

3. *Nga auditimi i dokumentacionit tregtar të praktikave doganore lidhur me vlerësimin doganor dhe klasifikimin tarifor të mallrave të importuar rezultuan: keqklasifikim të artikullit “Të brendshme, stomak pule”, në kodin tarifor me kre *0504* ku edhe pse dokumentacioni tregtar për këtë artikull lëshuar nga vende të BE, si dhe referuar notave shpjeguese të Nomenklaturës së Kombinuar dhe Harmonizuar të Mallrave, artikulli klasifikohet në kodin tarifor me kre *0207* me nivel preferencial të taksës doganore 10 %, trajtim i artikujve “Mish & Pastë pule” me transaksion, veprime këto, jo në përputhje dhe shkelje të kërkesave të nenit 33-37, 256.1/a, 256.2 dhe 261.1 të KD si dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të MF*

“Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, dosjes së të dhënave të disponueshme për shpenzimet e transportit...”

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 20-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të marrë masa për të anuluar (shfuqizuar) shkresat **nr. 1945 prot., datë 25.01.2016** dhe **nr. 2344 prot., datë 28.01.2016** të DPD-së lidhur me vlerësimin doganor të mallrave, të cilat bien ndesh me kërkesat e Sesionit I të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të MF “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore... dosjes me të dhënat e disponueshme për shpenzimet e transportit...” si dhe shkresës së Departamentit Teknik nr. 8135 prot, datë 30.05.2012, lidhur me klasifikimin tarifor të artikullit “të brendshme, “stomak pule”.

Menjëherë

4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nuk ka marrë masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimit të lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në auditimin e mëparshëm, për të siguruar nga organet kompetente dhe komisioni Ad-Hoc, pranë Ministrisë së Financave çmimin referues për eksportin e artikullit hekur, me qëllim krahasimin e çmimit të deklaruar nga subjekti me çmimin referues të miratuar, nga strukturat e specializuara për të mbajtur në kontroll të plotë realizimin e të ardhurave të programuara nga arkëtimi i taksës së rentës minerare në eksport.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 14-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave (komisionin Ad-Hoc), të marrin masa të plota ligjore, për të nxjerrë çmime referuese lidhur me eksportin e artikullit hekur, me qëllim rritjen e të ardhurave doganore nga taksa e rentës minerare që zbatohet në momentin e eksportit.

Në vijimësi

5. Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Qafë Thanë - Pogradec nuk e ka zbatuar plotësisht rekomandimin e lënë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në auditimin e mëparshëm, lidhur me hipotekimin e Pikës Doganore Tushemisht me vlerë 89,073 mijë lekë dhe marrjen e çertifikatës së pronësisë, konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, pavarësisht pengesave të krijuara nga ish Komuna Buçimas dhe ZVRPP-Pogradec. Megjithëse autoriteti doganor kompetent ka plotësuar pothuaj të gjitha dokumentet e domosdoshme për hipotekimin dhe marrjen e Çertifikatës së Pronësisë, por nuk e ka ndjekur këtë detyrë hap pas hapi e me përgjegjësin e duhur.

Sa më sipër, trajtuar më hollësisht në faqet nr. 14-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Qafë Thanë – Pogradec, të marrin masa të plota për hipotekimin e Pikës Doganore Tushemisht deri në marrjen e

Çertifikatës së Pronësisë nga ZVRPP-Pogradec duke ngarkuar me këtë detyrë një person nga Stafi i doganës deri në zbatimin e përfundimtar të këtij rekomandimi.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Autoriteti doganor kompetent, *Dega e Doganës Qafë Thanë - Pogradec*, të bëjë kontabilizimin e detyrimeve doganore së bashku me penalitetet përkatëse dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e detyrimeve në vlerë **33,431,069 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, për sa më poshtë:

1. *Nga auditimi i dokumentacionit tregtar dhe i procedurave doganore të zbatuara gjatë deklaramit të mallrave në doganë, u konstatuan raste të keqklasifikimit tarifor të disa artikujve, shqyrtime të parregullta të vlerës së mallrave për qëllime doganore si dhe gjatë verifikimit të sasisë së mallrave të deklaruar, (tepër apo mangët), veprime këto që bien ndesh me kërkesat e ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenet 34-37, 256.2, 256.4, 261.1 dhe 261.2, të kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të të dhënave të disponueshme.”, si dhe veprime jo në përputhje me kërkesat e publikuara nga MF me Udhëzimin nr. 24, datë 11.09.2015 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007”, nxjerrë për këtë qëllim.*

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 20-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti doganor kompetent, *Dega e Doganës Qafë Thanë - Pogradec* të bëjë kontabilizimin e detyrimeve doganore së bashku me penalitetet përkatëse duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore, nëpërmjet zbatimit të procedurave administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **108 raste** në vlerë **21,832,277 lekë**, sipas anekseve nr. 1-11.

Deri më 30.01.2017

2. *Nga auditimi i dokumentacionit tregtar dhe i procedurave doganore të zbatuara gjatë deklaramit të mallrave në doganë, u konstatuan raste të keqklasifikimit tarifor të disa artikujve, shqyrtime të parregullta të vlerës së mallrave për qëllime doganore si dhe gjatë verifikimit të sasisë së mallrave të deklaruar, (tepër apo mangët), veprime këto që bien ndesh me kërkesat e ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenet 34-37, 256.2, 256.4, 261.1 dhe 261.2, të kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit nr. 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit të të dhënave të disponueshme.”, si dhe veprime jo në përputhje me kërkesat e publikuara nga MF me Udhëzimin nr. 24, datë 11.09.2015 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007”, nxjerrë për këtë qëllim.*

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 20-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti doganor kompetent, *Dega e Doganës Qafë Thanë - Pogradec* të bëjë kontabilizimin e detyrimeve doganore së bashku me penalitetet përkatëse duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore, nëpërmjet zbatimit të procedurave administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **5 raste** në vlerë **205,932 lekë**, të krijuar nga subjektet “████████”, në vlerë 123,200 lekë, subjekti “████████”, në vlerë 24,775 lekë, subjekti “████████”. për dy raste në vlerë 14,753 lekë dhe subjekti ██████████, në vlerë 43,204 lekë.

Deri më 30.01.2017

3. *Nga auditimi i dokumentacionit për vendimet administrative të nxjerra nga autoriteti doganor kompetent, për shkeljet e konstatuara në fushën doganore rezultuan: Vendime të marra për subjekte që kanë rezultuar me shkelje me pasojë shmangien e detyrimeve doganore, por që nuk janë penalizuar referuar natyrës së shkeljes; si dhe penalitete të zbatuara jo në masën e duhur dhe jo përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i RSH”, nenet 256.2, 275.1, 275.2, 273.2, 261.1, 261.2 dhe 287.2/f.*

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 63-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti doganor kompetent, *Dega e Doganës Qafë Thanë - Pogradec* të marrë masa për kontabilizimin e detyrimeve të konstatuara së bashku me penalitetet e zbatuara, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore duke zbatuar të gjitha procedurat administrative dhe gjyqësore, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **12 raste**, në vlerë **2,999,100 lekë**, sipas aneksit nr. 12.

Deri më 30.01.2017

4. *Nga auditimi i dokumentacionit tregtar dhe shkresor të paraqitur nga dogana, në lidhje me autorizimet e lëshuara nga Zyra e Regjim/Akcizës për përjashtimet nga detyrimet doganore të mallrave që sjellin subjektet, të cilët lenë vendbanimet e tyre, si dhe vendimet administrative të revokuara, rezultuan se:*

- Janë lëshuar autorizime për përjashtimin nga detyrimet doganore jo në përputhje me kërkesat e nenit 184.3/a të Ligjit 102/2014 Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë; pikave 96-104 të VKM nr. 919, datë 29.12.2014 (Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor); nenit 56.3 të Ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” si dhe me kërkesat e Udhëzimit nr. 4, datë 03.12.2015 të D.P.D “Mbi operacionet e privileguara” pikës 4/c ku kërkohet; “Vërtetim për lënien e rezidencës nga organi përkatës i shtetit prej nga vjen individi”;

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 70-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, rekomandojmë:

Autoriteti doganor kompetent, *Dega e Doganës Qafë Thanë - Pogradec* të marrë masa për kontabilizimin e detyrimeve të konstatuara së bashku me penalitetet e zbatuara, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore, duke zbatuar të gjitha procedurat administrative dhe gjyqësore, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **10 raste**, në vlerë **839,266** sipas aneksit nr. 13.

Deri më 30.01.2017

5. Nga auditimi i dokumentacionit tregtar dhe shkresor të paraqitur nga dogana, në lidhje me autorizimet e lëshuara nga Zyra e Regjim/Akcizës për përjashtimet nga detyrimet doganore të mallrave që sjellin subjektet, të cilët lenë vendbanimet e tyre, si dhe vendimet administrative të revokuara, rezultuan se:

- janë lëshuar autorizime për përjashtimin nga detyrimet doganore jo në përputhje me kërkesat e nenit 184.3/a të Ligjit 102/2014 Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë; pikave 96-104 të VKM nr. 919, datë 29.12.2014 (Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor); nenit 56.3 të Ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” si dhe me kërkesat e Udhëzimit nr. 4, datë 03.12.2015 të D.P.D “Mbi operacionet e privileguara” pikës 4/c ku kërkohet; “Vërtetim për lënien e rezidencës nga organi përkatës i shtetit prej nga vjen individi”;

Sa më sipër trajtuar më hollësisht në faqet nr. 75-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, **rekomandojmë:**

Autoriteti doganor kompetent, Dega e Doganës Qafë Thanë – Pogradec, të marrë masa për kontabilizimin e detyrimeve të konstatuara së bashku me penalitetet e zbatuara, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore, duke zbatuar të gjitha procedurat administrative dhe gjyqësore, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **11 raste**, në vlerë **1,003,994 lekë**, sipas aneksit nr. 14.

Deri më 30.01.2017

6. Për vlerën 6,550,000 mijë lekë, të nxirren vendime administrative dhe të bëhet kontabilizimi i tyre, për të gjitha subjektet rast pas rasti, bazuar në listën e paraqitur në faqet 16-17 të Raportit Përfundimtar të Kontrollit të vitit 2013, sipas rekomandimit nr. 24 të Vendimit të KLSH-së, lënë në auditimin e mëparshëm dërguar në Degën e Doganës me shkresën përcjellëse nr. 494/6, datë 12.04.2013, e cila bën fjalë për importin e artikullit viça të gjallë, në 131 raste të konstatuara sipas listës së detyrimeve doganore të papaguara, paraqitur në vlerë sa mësipër. Ky rekomandim është trajtuar në faqet nr. 14-16 të RP të Auditimit (2016).

Deri më 30.03.2017

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë: Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave dhe Kryetarit të Degës Doganore, Qafë Thanë - Pogradec që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme sipas pikës 1 gërma “a”, “b” dhe “c” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 të konsideruara nga ana jonë si shkelje shumë të rënda, të rënda dhe të lehta, të bëjnë klasifikimin e tyre dhe të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

a. Neni 58 gërma “c”, “largim nga shërbimi civil” për nëpunësin civil, si më poshtë:

1. Për znj. M. Zh. (Ll.) me detyrë doganiere regjim/përjashtime, në Degën e Doganës Qafë Thanë, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, konkretisht:

- për problemet e konstatuara në lidhje të lëshimit të autorizimeve për përjashtimin nga detyrimet doganore jo në përputhje me kërkesat e nenit 184.3/a të Ligjit 102/2014 Kodi Doganor në Republikën e Shqipërisë; pikave 96-104 të VKM nr. 919, datë 29.12.2014 (Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor); nenit 56.3 të Ligjit nr. 92/2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” si dhe me kërkesat e Udhëzimit nr. 4, datë 03.12.2015 të D.P.D “Mbi operacionet e privileguara” pikës 4/c e cila citon “Vërtetim për lënien e rezidencës nga organi përkatës i shtetit prej nga vjen individi” (*Trajtuar hollësisht në faqet nr. 70-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

b. Neni 58 gërma “a-b”, nga “vërejtje” deri në “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” për nëpunësit civil, si më poshtë:

2. Për znj. B. K., me detyrë jurist/specialist borxhi, në Degën e Doganës Qafë Thanë, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, konkretisht për; *Veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 261.1 dhe 261.2 të KD, pasi për subjekte që kanë rezultuar me shkelje me pasojë shmangien e detyrimeve doganore më shumë se 5 % e detyrimeve doganore të paguara, nuk është vendosur penaliteti përkatës;

* Veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 256.2 dhe 275.1 të KD, pasi për shkelje në fushën doganore nuk janë mbajtur penalitetet përkatëse;

* Veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 273.2 të KD, pasi për subjekte që operojnë në kushtet e RLP nuk janë penalizuar referuar natyrës së shkeljes.

(*Trajtuar hollësisht në faqet nr. 20-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3. Për z. I. M. me detyrë doganier klasifikim/vlerë;

4. Për z. K. R. me detyrë doganier klasifikim/vlerë;

5. Për z. A. P. me detyrë doganier klasifikim/vlerë, në Degën e Doganës Qafë Thanë, për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Degëve Doganore, konkretisht për:

-praktika doganore të cilat janë trajtuar me transaksion jo në përputhje me kërkesat e neneve 33-37 të Kodit Doganor dhe kërkesave të Sesionit I të Udhëzimit 25, datë 30.11.2007 të Ministrisë të Financave “*Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore, burimet e informacionit dhe afatet e publikimit me të dhënat e disponueshme..*”, nxjerrë për këtë qëllim si dhe veprimet jo në përputhje me kërkesat e publikuara nga MF me Udhëzimin nr. 24, datë 11.09.2015 “*Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 25, datë 30.11.2007*”;

- praktika doganore me keqklasifikim artikujsh me pasojë shmangie të detyrimeve doganore, jo në përputhje me kërkesat e neneve 256.1/a; 256.2; 256.4; 261.1 dhe 261.2 të KD;

- praktika doganore të cilat kanë rezultuar me diferenca në peshë në lidhje me sasinë e deklaruar, të cilat janë trajtuar jo në përputhje me nenin 256.1/a; 256.2; 275.1 dhe 287.2 të KD.

- praktika doganore të cilat rezultojnë me shkelje të kushteve të RLP-së, në shkelje të nenit 256.2; 275.1, 273.1 të KD, dispozitës 384.5/a si dhe pikës 6.c të Udhëzimit nr. 08, datë 08.08.2014 të DPD “*Mbi trajtimin e mjeteve të regjistruara jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, që thyejnë Regjimin e Lejimit të Përkohshëm të automjeteve për përdorim privat.....*”, pasi, kanë kaluar afatet e përcaktuara (ditë

qëndrimi) apo ndryshim pronësie. (Trajtuar hollësisht në faqet 20-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Shënim:

I. Duke analizuar mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, mbi natyrën e shkeljeve dhe të mangësive, për doganierët: z. O. E., me detyrë Kryetar i Doganës, z. Y. B., A. B., S. H. me detyrë Shefa Turni dhe z. N. T. doganier në zyrën Aposteriori/Risku, është menduar të mos rekomandojmë masë disiplinore.

II. Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandojmë masë disiplinore për ish-punonjësit e poshtë shënuar, mbasi ata janë të larguar nga sistemi doganor:

1. z. R. M. në cilësinë e përgjegjësit të turnit;
2. z. Ll. T. në cilësinë e doganier klasifikim/vlerë.

Me ndjekjen dhe zbatimin e masave të rekomanduara me këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Bujar **LESKAJ**

K R Y E T A R